



Aleanca për
Media
Etike

VENDIM NR.30

Ankuesi: Elda Ibro

Kundër: Joq Albania

Titulli i artikullit objekt ankimi:

Me EMRA dhe FOTO/ Pronarët dhe shoqëritë mikrofinanciare, të cilat denoncohen nga shqiptarët për zhvatje dhe mashtrim

Vjegëza e artikullit objekt ankimimi:

<https://joq-albania.com/artikull/981669.html>

Bordi i Aleancës për Media Etike pasi shqyrtoi ankesën,

KONSTATOI

1. Artikulli nuk është i balancuar, pasi në të nuk është referuar edhe sqarimi i personit të përmendur në artikull, si palë e prekur.
2. Gjuha e përdorur në artikull nuk është etike dhe ka



Aleanca për
Media
Etike

elemente urrejtjeje.

3. Publikimi i fotos nuk përbën shkelje, pasi është ripublikim i marrë nga një media tjetër dhe nuk ka konotacion negativ.

Për këtë arsye nuk është e nevojshme që të hiqet.

Bazuar mbi sa më sipër, Bordi gjykon që,

1. Artikulli shkel **Nenin 1 të Kodit të Etikës së Gazetarit, Gazetaria e Paanshme** që thotë se "Gazetarët duhet të bëjnë çmos për të ofruar raportim të paanshëm dhe të balancuar. Gazetarët gjithmonë duhet t'u referohen burimeve në dispozicion dhe palëve të interesuara që mund të ofrojnë informacion të dobishëm dhe të rëndësishëm për çështjen."
2. **Nenin 13 të Kodit të Etikës së Gazetarit, Raportimi i Procedurave Gjyqësore dhe Prezumimi i Pafajësisë** që thotë se "Gazetarët duhet të respektojnë gjithmonë prezumimin e pafajësisë dhe duhet të rezistojnë ta përshkruajnë dikë si kriminel përpara vendimit përfundimtar nga gjykata."

Mbështetur në këto arsyetime, Bordi,



Aleanca për
Media
Etike

VENDOSI

T'i rekomandojë medias Joq Albania:

1. Të rishikojë përmbajtjen e artikullit duke qartësuar që personi i prekur është kontaktuar për të dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë çështje. Ky rishikim i përmbajtjes mund të realizohet duke vendosur një "Shënim" në fund të artikullit ose duke publikuar një artikull të ri.

2. Të jetë më e kujdesshme në etiketimet e përdorura në tekst, pasi informacionet e dhëna mbeten dyshime dhe nuk janë fakte të pranuar nga Gjykata.

Publikuar më 24 Shkurt 2022



Aleanca për
Media
Etike